

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“SEIM INTERNATIONAL“**

Sot, me date 10.06.2023:

• **Z. Natale Dipierro**, qytetar italian lindur ne Noicattaro (BA), me 10.01.1944, rezident ne Via Don Giovanni Manzoni 6 Noicattaro (BA)(Itali), me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pashaportes nr. YB6076119

mbeshtetur ne Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008, “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ka vendosur te krijoje shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar te quajtur “SEIM INTERNATIONAL” shpk me aktin e themelimit si vijon:

**FORMIMI I SHOQERISE**

**Neni 1**

Formohet shoqeria tregtare e quajtur “SEIM INTERNATIONAL” sh.p.k.

**SELIA E SHOQERISE**

**Neni 2**

Selia e shoqerise tregtare “SEIM INTERNATIONAL” shpk do te jete ne Tirane, Rruga Jeronim de Rada, Nd.1, H.25, Ap.40.

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

**Neni 3**

Shoqeria do te kete objekt veprimtarie:

- ofrimi i sherbimeve te asistencës, konsulencës, trajnimit, planifikimit, programimit dhe projekteve të menaxhimit për kompani, privatë, ente publike dhe private në fushën e sistemeve informative dhe informatike të telematikës, eidomatikës dhe rrjeteve të lidhjes (internet, intranet, ekstranet);
- konceptimi, projektimi, krijimi dhe zhvillimi i aplikacioneve në fushën e informatikes dhe telematikës;
- konceptimi, hartimi dhe zbatimi i programeve softuerike dhe dhënia e licencave përkatëse për përdorim;
- krijimin dhe menaxhimin vetë, në emër të palëve të treta ose si përfaqësues me ose pa kontratë agjencie, të dyqaneve virtuale, e-commerce, qendrave të thirrjeve, galerive virtuale të shitjeve (postë elektronike) dhe çdo forme tjetër të tregtisë në distancë, elektronike dhe me postë, duke përfshirë shërbimet përkatëse në lidhje me reklamimin dhe promovimin;
- ofrimi i shërbimeve të asistencës, konsulencës dhe trajnimit për kompanitë, individët, entet publike dhe private në fushat e menaxhimit të biznesit, organizimit të biznesit, administratës dhe financave, shitjes, marketingut, komunikimit dhe reklamimit, kërkimit dhe zhvillimit,

prodhimit të mallrave dhe shërbimet, të sistemeve të cilësisë, të sigurisë, respektimi dhe mbrojtja e mjedisit;

- organizimi, drejtimi dhe menaxhimi i nismave specifike në lidhje me fushat e përshkruara më sipër, duke marrë përsipër role dhe detyra specifike pro-kohore në kompani dhe ente publike ose private;

- asistencë e përgjithshme dhe specifike për sipërmarrësin, organet administrative, drejtorive të përgjithshme dhe drejtorive rajonale, e funksionit dhe e divizionit në administrimin menaxherial dhe sipërmarrës;

- kryerjen e shërbimeve të sekretarisë dhe përpunimit të të dhënave, ofrimin e shërbimeve bazë dhe logjistike, dhënien me qira të pasurive të luajtshme, mjeteve motorike dhe pasurive të paluajtshme, kryerjen e aktiviteteve të zyrës qendrore dhe shërbimeve përkatëse;

- organizimi dhe menaxhimi i nismave botuese të shkruara, radio dhe televizione, on line në internet ose në lloje të tjera rrjetesh, si multimediale, ashtu edhe në media magnetike dhe/ose dixhitale, dhe në çdo formë tjetër dhe me çdo mjet tjetër ose mbështetje që teknologjia dhe shkenca do të përpunojnë me përjashtim të gazetave;

- tregtimin e mallrave, licencave dhe shërbimeve të lidhura me pikat e mëparshme;

- aktiviteti industrial, tipografik, grafik dhe redaktues i prodhimit dhe tregtia përkatëse e gazetave, duke përfshirë gazetatat e përditshme, periodikët, librat, produktet, shërbimet editoriale dhe të lidhura me informacionin në përgjithësi, të të gjitha llojeve dhe formave, me çdo mjet dhe teknologji dhe nëpërmjet çdo platforme, të realizuara në çdo lloj suporti, letër ose jo; mbledhja, menaxhimi, perhapja dhe shpërndarja e të dhënave si dhe tregtimin e mallrave dhe shërbimeve nëpërmjet mjeteve dhe platformave të komunikimit të të gjitha llojeve;

- veprimtari për prodhim radiofonik dhe/ose televiziv dhe në përgjithësi shfrytëzim nëpërmjet mjeteve audio dhe/ose vizuale, virtuale, multimediale, të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe çdo veprimtari që lidhet me informacionin, argëtimin, kulturën dhe formimin;

- aktivitet reklamues në përgjithësi, edhe në formën e shkëmbimit, në çdo mjet informacioni dhe komunikimi, me çdo teknologji dhe çdo aktivitet të ndërlidhur, si organizimi i eventeve, shfaqjeve, fushata sponsorizimi dhe promovimi, menaxhim të buxheteve publicitare, si dhe në përgjithësi veprimtari promovuese, në çdo formë dhe me çdo mjet, të veprimtarive tregtare;

- promovim turizmi nëpërmjet përmirësimit të dekorimit urban dhe rikuperimit të formave origjinale dhe historike të strukturës urbane dhe emergjencave arkitekturore; përmirësimi i kushteve të aksesueshmërisë dhe furnizimi me infrastruktura për lëvizshmëri të qëndrueshme; ofrimi i shërbimeve dhe aktivizimi i sistemeve, përfshirë ato inovative dhe eko-të qëndrueshme, për pritjen e turistëve edhe nëpërmjet rimëkëmbjes funksionale të ndërtesave dhe hapësirave publike.

Me qëllimin e vetëm të realizimit të objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo transaksion mobiluar, imobiluar, industrial, financiar dhe tregtar, të dobishëm ose të nevojshëm, si dhe çdo transaksion tregtar, gjithashtu për qëllime të investimeve kapitale dhe rezervave. Gjithashtu, ajo mund të ketë interesa dhe të marrë pjesë në shoqëri të tjera që kanë objekte veprimtarie të çfarëdo lloji natyre, të

ngjashme, apo qe lidhen me aktivitetin e saj; ajo mund te jape gjithashtu garanci te pergjithshme, apo edhe reale per pale te treta. Te gjitha aktivitetet e mesiperme duhet te kryhen brenda limiteve ose ne perputhje me normat qe rregullojne aktivitetin.

#### **Neni 4**

Per kryerjen e veprimtarise se saj Shoqeria mund te hape zyra te tjera, njesi perpunimi, sherbimi tregetimi dhe te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

#### **Neni 5**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me afat te pacaktuar.

### **KAPITALI SHOQERISE, KONTRIBUTET DHE KUOTAT**

#### **Neni 6**

Kapitali fillestar i shoqerise tregtare "SEIM INTERNATIONAL" shpk do te jete i barabarte me Leke 100.000(njeqind mije) dhe do te perbehet nga kuota e ortakut themelues te shoqerise.

Kapitali themeltar ndahet ne 1(nje) kuote, me vlere nominale prej 100.000 (njeqind mije) leke.

**Z. Natale Dipierro**, qytetar italian lindur ne Noicattaro (BA), me 10.01.1944, rezident ne Via Don Giovanni Manzoni 6 Noicattaro (BA)(Itali), me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i pashaportes nr. YB6076119 ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 100.000 (njeqind mije) leke.

Sipas kontributit te siperpermendur shoqerise z. Natale Di Pierro, i perket 1(nje) kuote, qe i korrespondon 100% (njeqind per qind) te kapitalit te Shoqerise.

#### **Neni 7**

Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te transferohen sipas parashikimeve ne Statut dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

### **ORGANIZIMI I SHOQERISE**

#### **Neni 8**

Organi vendimmarres i Shoqerise eshte Ortaku Themelues.

#### **Neni 9**

Ortaku Themelues ka te drejte te emeruje nje apo me shume administratore, te cilet jane perfaqesuesit ligjore te shoqerise ne menyre kolegjiale. Ata mund te nderrmarrin te gjitha veprimet e zakonshme dhe

te jashtezakonshme te administrimit, por gjithmone brenda kufijve qe u jep atyre Statuti i shoqerise.

#### **Neni 10**

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen dhe zgjidhen ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

#### **Neni 11**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregetare".

#### **Neni 12**

Akti i themelimit, u perpilua ne 2(dy) kopje ne gjuhen italiane me perkthimin perkates ne gjuhen shqipe, per t'iu shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise tregetare "SEIM INTERNATIONAL" sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

#### **ORTAKU THEMELUES**

**Z. Natale Dipierro**

Natale Dipierro AD